REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT
T I R A N E
Nr 15585 Vendimit

15585

# V E N D I M

Sot me date 06/08/1996 ne Gjykaten e rrethit Tirane, une Merita Gjinzi gjyqtare e kesaj gjykate, pasi u njoha me materialin e paraqitur nga Ibrahim Ademi per te bere regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar(sh.p.k.) me emrin "SAT KONSTRUKSION"

# K O N S T A T O V A

Se kerkuesi Ibrahim Ademi se bashku me Sali Shiren, kane themeluar sho shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "SAT KONSTRUKSION" me seli ne qytetin e Kavajes dhe me te drejte per te ushtruar aktivitetin ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise per kohezgjatje jo me pak se dhjete vjet, me kapital themeltar prej 100.000 leke.

Veprimtaria qe do te ushtroje kjo shoqerika per objekt: Punime dheu, sisteme, tarracim terrenesh(kategoria 1); prodhim materiale inerte, rere, cakell, gure mermere(kat.2/a); ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore dhe kompletime instalimet e nevojeshme per to(kat.3/a); ndertim ujsjellsa dhe kanalizime(kat.8/b); rikonstruksione godinash Civile dhe ekonomike veshje fasadash(kat.10/a); mirmbajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane(kat. 14/d) si dhe import-eksport materialesh ndertimi, projektim e zbatim.

Me qenese personi ka paraqitur edhe licensen e dhene nga Ministria e Ndertimit dhe Turizmit dhe kerkesa per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SAT KONSTRUKSION" eshte e drejte dhe si e tille ajo suhet pranuar;

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 dhe ligjit nr.7667 dt.28.11.92

# V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SAT KONSTRUKSION", Me ortake Ibrahim Ademi e Sali Shira, me seli ne qytetin e Kavajes, dhe me te drejte per te ushtruar aktivitetin ne te gjithe teritorin e republikes se Shqiperise, me kohezgjatje jo me pak se dhjete vjet, me kapital fillestar 100.000 leke dhe objekt te veprimtarise: punime dheu, sisteme, taracimmi terrenesh; prodhim materialesh inerte, rere, cakell, gure mermer; ndertime civile, industriale, turistike bujqesore dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to; ndertim ujsjellesi dhe kanalizime; rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash; mirmbajtej zhvillim dekori ne mjedise urbane import eksport materialesh ndertimi, projektim e zbatim½. Kunder ketij vendimi lejohet ankim

GJYQTARE

Merita Gjinzi

REPUBLIKA SHQIPËRISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 15585/1 VENDIMI

# V E N D I M

## I gjyqtarit te vetem

Ne Tirane sot me date 25.07.1997, Une Oferta Gjikdi gjyqtare ne Gjykaten e rrethit Tirane mbasi studjova kerkesen dhe materialet e tjera te paraqitura nga Sali Shira dhe Ibrahim Ademi për kryerjen e disa ndryshimeve dhe rregjistrimin ne rregjistrin tregtar Tirane te SH.P.K. me ortakeri " SAT KONSTRUKSION " :

## K O N S T A T O V A

Se me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane Nr.15585 date 06.08.1996 eshte rregjistruar si person juridik shoqeri me përgjegjes te kufizuar me ortakeri " SAT KONSTRUKSION " me seli ne lagjen Nr.4 te qytetit te Kavajes,me kapital themeltar 100.000 lek,me kohe zgjatje te veprimtarise ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet,me administrator zotin Ibrahim Ademi,me objekt te aktivitetit tregtar privat punime dheu, sistemime,taracime terenesh etj;(Kat.1);Prodhim material ndertimi inert rere,çakell,gure,mermer etj.(Kat.2/a);Ndertime civile,industriale, turistike,bujqesore dhe kompletimin me instalimet e nevojshme për to (Kat.3/a);Ndertim ujesjelles dhe kanalizime (Kat.8/b);Rikonstruksione godinash civile e ekonomike,veshje fasadash etj (Kat.10/a);Mirembajtja zhvillimi dekorit ne mjedise urbane (Kat.14/a) si dhe import eksport materialesh ndertimi,projektim e zbatim.

Me vendimin Nr.1 date 21.07.1997 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur shkarkimi nga detyra e administratorit te shoqeris te z.Ibrahim Ademi dhe caktimi ne detyren e administratorit te SH.P.K. me ortakeri " SAT KONSTRUKSION " te z.Sali Shire si dhe shtimi i objekti te aktivitetit tregtar te shoqeris edhe te punimeve ndertimore Kat.2

Predhim material ndertimi ( germat e,f,g ) ; Kat.4 Ndertime rugore e aer aeroporte (germat a,b ); Kat.8 Ndertime hidroteknike (germa c ) ; Kat.11 Punime karpentjerie ( germat a,b); Kat.14 Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje (germat a,b,c).

Kjo kerkese eshte e bazuar ne ligje dhe duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te Ligjit 7638 dt.19.11.1992 dhe Ligjit 7667 dt.28.01.1993

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.

- Depozitimin ne zyren e rregjistrit tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te SH.P.K. "SAT KONSTRUKSION ".

- Urdherimin e zyres se rregjistrit tregtar te Gjykates se rrethit Tirane te beje ndryshimet ne kolonen 4. 5 ne rregjsitrin tregtar.

- Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Merita Gjeçaj[?]

Urdhër rregjistrimi

(a) "Sat - konstruksion" (15585)

(b) Kavajë. Lagja 4.

(2) Punime dheu, sistemime, tarracime, prodhim materiale inerte, ndërtime civile, punime industriale, rikonstruksione, mirëmbajtje etj.

(3) 100.000 lekë

(4) Ibrahim Adem
Gali Saira

5 10 fletë.

= Akti themelimit. 2 fletë dt 31/07/1996
= Statuti. 4 fletë dt 31/07/1996

= Licencë NR 3040 Rep

GJYGJTARE

Merita Gjonti

## AKTI I THEMELIMIT

## TE SHOQERISE "SAT KONSTRUKSION" SH.P.K.

Sot me daten 30.7½1996 ne te quqjturit :

1.Sali Osman shira ,lindur ne diber e banues ne Kavaje lagja nr.4;

2.Ibrahim Faslli Ademi.lindur e banues ne Kavaje lagja nr.4;

duke shprehur vullnetin tone te lire, themelojme Shoqerine Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar ,me emrin "SAT KONSTRUKSION" Sh.P.K.

neni 1

Shoqeria emerohet "SAT KONSTRUKSION" sh.p.k.

neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne qytetin e Kqvqjes lagja nr.2,me te drejte per te ushtruar veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

neni 3

Shoqeria ka nje veprimtari te saj me kohezgjatje jo me pak se 10 vjet dhe mund te shperbehet sipas percaktimeve te bera ne statutin e kesaj shoqerie.

neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Punime dheu,sisteme,tarracime terrenesh(kategoria 1);prodhim materiale inerte,rere cakkell,gure mermere etj.(kat.2/a);ndertime civile,industriale, turistike ,bujqesore dhe kompletime instalimet e nevojshme per to(kat.3/a) ndertim ujsjellsa dhe kanalizime(kat.8/b);rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike ,veshje fasadash(kat.10/a);mirmbajtje,zhvillim dekori ne mjedise urbane (kat.14/d) si dhe import eksport materialesh ndertimi,projektim e zbatim.

neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 leke dhe do te jete i ndare ne 100 kuota me vlere prej 1000 leke cdo kuote.

neni 6

Kapitali themeltar i shoqrise eshte i ndare ne menyre te barabarte mes dy ortàkeve me nga 50 kuota sejcili ortak.

ñeni 7

ñenyra e organizimit te shoqerise,kopetencat dhe te drejtat e ortakeve ,menyra e shperndarjes se fitimeve,menyra e likujdimit te shoqerise, caktohen ne statutin e saj dhe ne ligjin nr.7632 dt.4.11.1992 "Per shoqerite trgetare" dhe ne legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise

O R T A K E T

IBRAHIM ADEMI

SALI SHIRA

- - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
NR.3008 Rep. 10P4

Kavaje,me 31.7.1996

V E R T E T I M

Ne Kavaje sot me date 31/7/1996 perpara meje noter Frederik Tengut, u paraqiten personalisht ortaket themelues te Sh.p.k. "SAT KONSTRUKSION" me qender ne kavaje lagja nr.4,te cilet nenshkruan kete akt themelimi te sh.p.k.

Sa me siper pas firmosjes se tyre ne prezencen time,une noteri e vertetoj rregullisht.

N O T E R I
FREDERIK TENGU

# STATUTI I SHOQERISE

## "SAT KONSTRUKSION" SH.P.K.

### FORMIMI

neni 1

Me vullnetin e lire te ortakeve Sali Shira, lindur e banues ne Kavaje lagja nr.4, i datelindjes 28.1.1969, Ibrahim Alemi, lindur e banues ne Kavaje lagja nr.4 i datelindjes 1962, formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar"SAT KONSTRUKSION"(sh.p.k.).

### SELIA E SHOQERISE

neni 2.

Shoqeria do ta kete seline ne qytetin e Kavajes lagja nr.4 me te drejte per te ushtruar aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqeria mund te hape vendqendrime te tjera ... te dyta operative filjale, perfaqesi dhe axhensi ne te gjithe teritorin e vendit.

### KOHEZGJATJA

neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte jo me pak se dhjete vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

neni 4

Shoqeria "SAT KONSTRUKSION" ka per objekt te veprimtarise se saj kategorine e punimeve te percaktuara ne licensen e dhene nga Ministria e Ndertimit dhe Turizmit si:punime dheu,sisteme,tarracime terrenesh(kat egoria 1),prodhim materiale inerte,rere,cakell,gure,mermere etj.(kat.2/a) ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore dhe kompletimime instalimet e nevojshme per to(kat.3/a):ndertim ujsjellsa dhe kanalizime(kat. 8/b);rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike,veshje fasadash(kat. 10/a);mirmbajtje,zhvillim dekori ne mjedise urbane(kat.14/d) si dhe import-eksport materialesh ndertimi,projrktim e zbatim.

### EMERTIMI

neni 5

Shoqeria do te quhet "SAT KONSTRUKSION" dhe mund te ndryshoje emrin, seline si dhe objektin e saj sipas vendimeve qe mund te mare asambleja e ortakeve.

## KAPITALI I SHOQERISE

neni6

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke qe perfaqesom mjete monetare 1000 lekesecila kuote.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare mes ortakeve ne pjese t te barąbarta nga 50% per ortak ose nga 50 kuota.

neni 7

Ortaket kane te drejte te shtojne kuotat t etyre duke u bazuar ne vendimin e asamblese se ortakeve.

Kuotat mund te tjetersohen ne persona te trete .Njihet e drejta e parąblerjes prej ortakeve,nje e drejte e tille mund te ushtrohet brenda 30 diteve nga komunikimi i tjetersimit.Ne rast te tjetersimi te kuotave te kapitalit,te personave te tjere jo ortake,ortaku tjeter ka ne cdo rast te drejten e propozimit te bleresit.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

neni 8

Shoqeria "SAT KONSTRUKSION"deklarohet e krijuar ne zbatim te plote t te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuq qi.Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne librin e regjistrimit te shoqerive tregetare ne Gjykaten e Tiranes,ndersa ushtron aktivitetin e saj tregetar me regjistrimin ne Zyren e Tatimeve.

neni 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen"SAT KONSTRUKSION" [illegible] SH.P.K.

neni 10

Organet drejtuese te shoqerise sipas nenit 50 te Ligjit Nr.7638 dt.1 19.11.1992 dote jete Asambleja e Ortakeve dhe adminstratori.

Administrator i shoqerise eshte caktuar ortaku Ibrahim Ademi,i cili ka te gjitha te drejtat dhe kopetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ,sipas percaktimeve te bera ne nenin 50 te ligjit te mesiperm.

Asambleja e Ortakeve ka keto kopetenca:

-Miraton statutin dhe ndryshimet ne te.

-zgjedh adminstratorin .

-miraton humbjen ne llogari,bilancin dhe raportin e veprimtarise fina nciare vjetore,shperndarjen e rezultatit neto te vitit *(plus)fitimin e mbetur,vecanerisht percakton pagesen e dividentit per ortaket e saj.

neni 11

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Ortakeve behet te pakten nje her ne gjashte muaj.Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e ortakeve bren nda kufijve ligjore nga persona te besueshem prej tyre me prokure te r rregullt.

neni 12

Mbledhja e asamblese se ortakeve duhet te thirret duke u njoftuar ortaket 30 dite perpara me shkrim,me leter rekomande teleks ose fakskuduhet te shenohet edhe rendi i dites.

Mbledhja e Asamblese se ortakeve duhet te drejtohet nga nje kryetar i cili caktohet ne mbeledhjen e para te ortakeve.

neni 13

Administratori zgjidhet nga mbledhja e asamblese se ortakeve i cili zgjidhet nje here ne kater vjet.Ai mund te zgjidhet edhe pa kufizim.

Sipas nenit 10 te ketij statusi shoqeria "SAT KONSTRUKSION" Sh.p.k. ne veprimtarine e perditshme do te drejtohet nga adminstratoriIbrahim Ademi.Administratori ka keto kopetenca:

-Te pergatise mbledhjen e Asamblese se Ortakeve dhe te jape propozimet dhe mendimet e tij.

-Te zhvilloje,zbatoje kontrolloje politiken ekonomike te shoqerise si dhe te jape orientimet e nevojshme per drejtimin e veprimtarise ne perputhje me rregullat dhe ligjet.

-te punoje gjithmone ne interes te shoqerise.

BILANCI TE ARDHURAT

neni 14

Veprimtaria ekonomike financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor t te cdo viti.Ne fund te cdo periudhe ushtrimore,administratori nxjerrbilancin kontabel shoqerise,llogarine fitim-humbje,mbeshtetur ne ligje dhe rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private,percaktuar nga organet kopetenteb te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel,miratohet nga asambleja e ortakeve e cila vendos per zhvillimin e garancine e veprimtarise se shoqerise,fondin e akumulimit,fondin e rezervave etj.

neni 15

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore te permendura me siper dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale ,administrohen dhe ndahen sipas percaktimeve te bera ne nenin 10 te ketij statuti nga asambleja e ortakeve

SHPERNDARJA E SHOQERISE

neni 16

Shoqeria mund te shperndahet perpara afattit te percaktuar ne kete statut ne keto raste:

-me unanimitet te ortakeve;

-Pas dy vjeteve bilanc negativ me vendim te asamblese se jashtzakonshm

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

neni 17

E gjithe veprimtaria e shoqerise "SAT KONSTRUKSION" Sh.p.k.,do te bazohet ne ligjin nr.7638 dt.19.11.1992"Per shoqerite tregetare ",ne ligjin nr.7632 dt,04.11.1992"Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar",ne ligjin nr.7667 dt,28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe falimentimet qe duhen respektuar nga shoqerite trgetare ",ne legjislacion-in ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise si dhe aktet per zbatimin e t tyre ne kete statut.

neni 19

Ky statut u perpilua ne kater kopje per tju shperndare organeve kopete nte ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te theme-limit te shoqerise.

O R T A K E T

IBRAHIM ADEMI

SALI SHIRA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
NR.3008 Rep 10P4

Kavaje,me 31.7. 1996

V E R T E T I M

Me ane te te cilit vertetoj se sot me date 31/7 1996 para meje noter Frederik Tengu u paraqiten personalisht ortaket e mesiperm Ibrahim Faslli Ademi,lindur ne Kavaje me 25.12.1962 dhe banues ne Kavaje lagja nr.4,dhe Sali Osman Shira lindur ne Diber me 28.1.1969 e banues ne Kavaje lagja nr.4 per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat personale,te cilet nenshkruan me vullnetin e tyre te lire ne cdo flete te statutit te shoqeris "SAT KONSTRUKSION"sh.p.k. te perpiluar ne kater kopje.

Une noteri pas nenshkrimit te tyre ne pranine time e vertetova dhe e regjistrova,

NOTERI
FREDERIK TENGU

V E N D I M

Nr.1 date 21. 07. 1997

I Asamblese se Ortakeve

Shoqeria me përgjegjesi te kufizuar me ortakeri "SATKONSTRUKSION" eshte rregjistruar ne rregjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane ne baze te vendimit Nr.15585 date 6.08.1996,me seli ne lagjen Nr.4 te qytetit Kavaje,me kapital themeltar 100.000 lek,me kohe zgjatje te veprimtarise ekonomike pa ndeprerje mbi 10 vjet,me administrator z. Ibrahim Ademi,me objekt te aktivitetit tregtar privat ne fushen punime dheu,sistemime,taracime terenesh etj.(Kat.1);Prodhim material inerte rere,çakell,gure,mermer etj.(Kat.2/a);Ndertime civile,industriale, turistike,bujqesore dhe kompletimin me instalimet e nevojshme për te (Kat. 3/a);Ndertim ujesjelles kanalizime (Kat.8/b);Rikonstruksione godina civile e ekonomike,veshje fasadash etj.(10/a);Mirembajtje,zhvillim dekori ne mjedise urbane (Kat.14/d) si dhe import eksport materialesh ndertimi projektim e zbatim.

Duke qene se me deshiren e tij z.Ibrahim Ademi largohet nga detyra e administratorit te shoqeris si dhe shtimin e objektit te aktivitetit Asambleja e Ortakeve :

V E N D O S I

1. Shkarkimin nga detyra e administratorit te SH.P.K. me ortakeri "SAT KONSTRUKSION " z. Ibrahim Ademit me kerkesen e tij.

2. Caktimin ne detyren e administratorit te SH.P.K. me ortakeri "SAT KONSTRUKSION " te z. Sali Shira.---

3. Shtimin e objektit te aktivitetit tregtar privat te SH.P.K. me ortakeri " SAT KONSTRUKSION " ne Kat.2 Prodhim material ndertimi (germat e,f,g);Kat.4 Ndertime rrugore e aeroporte (germa a,b); Kat. 8 Ndertime hidroteknike (germa c ) ; Kat.11 Punime karpentjerie (germe a dhe b); Kat.14 Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje( germat a,b,c)

4. Vazhdimin e aktivitetit tregtar privat te shoqeris pa

nëryshime te tjera.-----

Ky vendim i Asamblese se Ortakeve u redaktua ne kater origji-nale dhe pasi u gjend i regullt nenshkruhet pa verejtje nga ortaket.---

O R T A K E T

Sali Shira Ibrahim Ademi

REPUBLIKA SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 4633 Rep.

V E R T E T I M

Ne Tirane sot me date 23.07.1997(njezetedhjet e shtate) u paraqite para meje Shpresa Spahiu notere ne kete qytet Sali Shira dhe Ibrahim Ademi banues ne Kavaje,madhore,me zotesi te plote juridike për te vepruar,për identitetin e te cileve u sigurova ne dokumentat përkatese, te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me deklaruan përmbajtje e vendimit Nr.1 date 21.07.1997 te Asamblese se Ortakeve te SH.P.K. me ortakeri "SAT KONSTRUKSION " duke e nenshkruar para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjes.

N O T E R I

NOTERE
SHPRESA SPAHIU

PULLE TAKSE 20 LEKE

REPUBLIKA SHQIPERISE
NOTERIA KAVAJE
VERTETIM
VERTETOHET ME ORIGJINALIN
NOTER FREDERIK TENGU

*MINISTRIA E NDERTIMIT DHE TURIZMIT*
*KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE*

Nr. 3040 Ref. Z. 1442
01.2.8.96

## L I C E N S E

Z. Sali Osman Shira, lindur me 28.02.1969, ne Diber me profesion inxhinier ndertimi, diplomuar ne vitin 1993, ne Fakultetin e Inxhinierise Ndertimit, Dega Ndertim, banues ne Diber.

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese i jepet license per zbatim dhe rregjistrohet ne regjistrin themeltar te zbatimit qe nga data 09.04.1996, per kategorite e specifikuara te punimeve:

Kat1- punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj.

Kat2/a- prodhim materiale inerte, rere, cakell, gure, mermere etj.
c- prodhim elementesh te parafabrikuar, betoni e b/a.

Kat3/a- ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, etj deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat8/b- ndertim ujesjellesa dhe kanalizime.

Kat10/a- rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj.

Kat14/d- mirembajtj, zhvillimi i dekorit ne mjedise urbane.

Sekretar i Komisionit
Engjell Gjoka

Kryetar i Komisionit
Andrea Mazniku

Pulla e Takses 087
data 28/6/96

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E NDERTIMIT DHE TURIZMIT TIRANE

**Shenim:** Kjo license eshte e vlefshme deri ne daten 09.04.1998.

K

PER REGJISTRIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" SAT KONSTRUKSION"

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

15584

Une Ibrahim Ademi me banim ne qytetin e Kavajes lagja nr.4 lindur me 25.12.1982 po ne qytetin e Kavajes bej kete kerkese Gjykates se rrethit Tirane per regjistrimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "SAT KONSTRUKSION" me dy ortak Ibrahim Ademi e Sali Shira ne baze te ligjit 7638 dt. dt,19.11.1992.

Kerkesen e mbyll me shprese se do te meret parasysh nga ana e kesaj Gjykate.

ME RESPEKT

K E R K U E S I

IBRAHIM ADEMI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE

Nr.3008 Rep 1014

Kavaje,me 31.7.1996

V E R T E T I M

Sot ne Kavaje,me 31.7.1996,para meje noter Frederik Tengu,u paraqit kerkuesi Ibrahim Ademi i cili lexoi dhe nenshkruajti kete kerkese per regjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar"SAT KONSTRUKSION" dhe une noteri ,pasi e nenshkroi e vertetoj firmen e kerkuesit.

N O T E R I

FREDERIK TENGU

- 15585 - 6/8/1996

K E R K E S E

KERKUESA : 1. Sali Shira ,lindur dhe banues ne qytetin e Kavajes.

2. Ibrahim Ademi lindur dhe banues ne qytetin e Kavajes.

REGJISTRUAR
DT: 25 07 97
CAKTUAR GJYQTARIT

OBJEKTI : Kerkojme rregjistrimin e dokumentave te SH.P.K. me ortakeri " SAT KONSTRUKSION " ne zyren e rregjistrit tregtar për ndryshimin e administrato dhe shtimin e objektit te aktivitetit tregtar,ne baze te Ligjit 7638 dt.19.11.92 dhe Ligjit 7667 date 28.01.1993.

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane Nr.15585 date 6.08.1996 eshte rregjistruar ne rregjistrin tregtar shoqeria me përgjegjesi te kufizuar me ortakeri " SAT KONSTRUKSION ",me seli ne lagjen Nr.4 te qytetit te Kavajes,me kapital themeltar 100.000 lek,me kohezgjat te veprimtarise ekonomike private per nderprerje mbi 10 vjet,me administrator z.Ibrahim Ademi,me objekt te aktivitetit tregtar privat ne fusheh punime dheu,sistemime,taracime terenesh etj,Kat.2/a Prodhim materiale inerte,rere,çakell,gure,mermer etj(Kat.3/a)Ndertime civile industriale,turistike,bujqesore dhe kompletimin me instalimet e nevojshm për to;Ndertim ujesjelles dhe kanalizime (Kat.8/b);Rikonstruksione godina civile e ekonomike,veshje fasadash (Kat.10/a);Mirembajtje,zhvilli dekori ne mjedise urbane(Kat.14/d) si dhe import eksport materialesh ndertimi,projektim e zbatim..

Me vendimin Nr.1 date 21.07.1997 te Asamblese se Ortakev eshte vendosur ndryshimi i administratorit te shoqeris e konkretisht ka hequr dore nga detyra e administratorit te shoqeris z.Ibrahim Ademi dhe ne detyren e administratorit te shoqeris eshte caktuar z.Sali Shira. Gjithashtu eshte vendosur shtimi i objektit te aktivitetit tregtar te

shoqeris e konkretisht edhe ne Kat.2 Prodhim material ndertimi (germa e,f,g);Kat.4 Ndertime rrugore e aeroporte (germa a,b); Kat.8 Ndertime hidroteknike ( germa c ); Kat.11 Punime karpentjerie (germa a dhe b ) ; Kat.14 Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime mirembajtjeje (germat a,b,c).

Përsa sipër kerkojme nga ana juaj miratimin e kesaj kerkese dhe rregjistrimin e dokumentave ne rregjistrin tregtar te kesaj Gjykate.

Korkuesat

Sali Shira  Ibrahim Ademi

REPUBLIKA SHQIPËRISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 4631 Rep.

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 23.07.1997(nentedhjet e shtate) u paraqiten para meje Sh. Spahiu notere ne kete qytet kerkuesat Ibrahim Ademi dhe Sali Shira banues ne qytetin e Kavajes,madhore,me zotesi te plote juridike për te vepruar,për identitetin e te cileve u sigurova ne dokumentat përkatese,te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me deklaruan përmbajtjen e kesaj kerkese duke e nenshkruar para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjes.

NOTERI

NOTERE
SHPRESA SPAHIU